



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA KORÇË

**DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PLANIFIKIMIT DHE KONTROLLIT TË
ZHVILLIMIT TË TERRITORIT DHE MENAXHIMIT TË KONTRATAVE
DREJTORIA E KONTROLLIT TË TERRITORIT**

Korçë, më _____. 2025

RELACION

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË BASHKISË KORÇË NR. 111,
DATË 03.08.2019, "MBI ZONAT E PARKIMIT ME PAGESË NË RRUGË", I NDRYSHUAR**

Në relacionin pararendës "Për një shtesë në vendimin e Këshillit të Bashkisë Korçë nr. 185, datë 28.12.2022, 'Për organizimin dhe funksionimin e shërbimit taksi në Bashkinë Korçë', u sqarua dhe u paraqit propozimi për të kryer një ndryshim në vendet e parkimit me pagesë, të cilat i përkasin zonës të Pazarit në rrugën "Kiço Greço". Pra tre vende parkimi me pagesë të kësaj zone të kalojnë në vendparkime taksi për automjetet elektrike. Me miratimin e propozimit të parë duhet të kryhet edhe ndryshimi në këtë zonë parkimi, kjo sipas plan-vendosjes bashkëlidhur.

**DREJTOR I DREJTORISË TË
PËRGJITHSHME JURIDIKE
Anxhela (Dishnica) Qeramixhi**

**KRYETARI I BASHKISË
Sotiraq Filo**

**DREJTOR I DREJTORISË TË
PËRGJITHSHME TË PLANIFIKIMIT
DHE KONTROLLIT TË ZHVILLIMIT
TË TERRITORIT DHE MENAXHIMIT
TË KONTRATAVE
Ndriçim Hoxha**

**PËRGJEGJËS I SEKTORIT TË LIÇENCIMIT
NË DREJTORINË E KONTROLLIT
TË TERRITORIT
Lorenc Palódhhi**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASHKISË KORÇË

P/VENDIM

Nr. _____, datë ____ . ____ . 2025

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË BASHKISË KORÇË NR. 111,
DATË 03.08.2019, “MBI ZONAT E PARKIMIT ME PAGESË NË RRUGË”, I NDRYSHUAR**

Këshilli i Bashkisë Korçë pasi shqyrtoi relacionin e Drejtorisë të Përgjithshme të Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit dhe Menaxhimit të Kontratave dhe Drejtorisë të Kontrollit të Territorit “Për një ndryshim në vendimin e Këshillit të Bashkisë Korçë nr. 111, datë 03.08.2019, ‘Mbi zonat e parkimit me pagesë në rrugë’, i ndryshuar, bazuar në ligjin nr. 8378, datë 22.07.1998, “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, neni 7, pika 1/f; ligjin nr. 139/2015, “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar, neni 54, pika k; ligjin nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës të Shqipërisë”;

VENDOSI :

- 1.Në pikën 1 të vendimit të Këshillit të Bashkisë Korçë, nënpika B ndryshohet si më poshtë:
B. Vendparkimet në rrugën “Kiço Greço” (zona e Pazarit 84 vende parkimi), sipas plan-vendosjes bashkëlidhur.
- 2.Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit dhe Menaxhimit të Kontratave, Drejtoria e Kontrollit të Territorit, Ndërmarrja e Shërbimeve Publike dhe Policia Bashkiake.
- 3.Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

KRYETARI I KËSHILLIT TË BASHKISË

Sekretari i Këshillit Bashkiak
Eva Naçi

Ana Verushi

Miratuar me _____ vota

Vota Pro _____

Vota Kundër _____

Vota Abstenim _____

Zbardhur më datë _____

ZONA E PAZARIT

84 Vend Parkime

